



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 03.11.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 30.10.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik PBC SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: RITENDER "Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS" me nr. të Prok: 206-23-571-2-1-1 nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik PBC SH.P.K, e dt. 30.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit RITENDER "Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS" me nr. të Prok: 206-23-571-2-1-1 kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 24.10.2023.
2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e AK të datës 24.10.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik PBC SH.P.K me date 30.10.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: RITENDER "Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS" me nr. të Prok: 206-23-571-2-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 03.11.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur sipas OE ankues PBC SH.P.K:

- Paragrafin 1 të nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092;
- Paragrafi 3, të nenit 56 të Ligjit Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092;
- Nenin 40.2 të Rregullores për Prokurim Publik nr. 01/2022;

- Paragrafin 2 të nenit 8, nenin 21, nenin 22, nenin 24, nenin 31 dhe nenin 278 të Kodit Penal të Kosovës, me numër 06/L-074;
- Paragrafin 1.7 të nenit 378 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës;
- Paragrafit 1 të nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

1) Pajtohem i fjalëpërfjalshëm me konstatimin e ekspertit të huaj që HIFIS dhe HIS janë dy sisteme të ndryshme. Në një procedurë të mëvonshme mund të shtojmë edhe një grumbull provash se pse ato sisteme nuk janë të njëjta.

2) Me marrjen e vendimit për diskualifikimin e ofertës sonë në kundërshti me kërkesat ligjore për trajtim të barabartë dhe jo-diskriminim, Autoriteti Kontraktues ka shkelur paragrafin 1 të nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

3) Përkundër që paragrafi 3, i nenit 56 të Ligjit Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, thotë që: "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit." dhe përkundër që neni 40.2 i Rregullores për Prokurim Publik nr. 01/2022 thotë që: [...Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve...]. Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka diskualifikuar ofertën tonë me arsyetimit se: "Certifikatat e ofruara nga OE e rekomanduar për kontratë nuk përmbushin këtë kusht, pasi nuk kanë kredibilitetin për shkak të mungesës së datës së lëshimit dhe të dhënave që duhet të posedojë një certifikatë e tillë e lëshuar nga institucionet vendore konform ligjit në fuqi, institucioni që lëshon çfarëdo lloje certifikate do të duhej të jetë i akredituar për atë program", pavarësisht se në Dosjen e Tenderit, Njoftimin për Kontratë dhe në sqarimet shtesë të datës 16.02.2023 dhe Formularit B54 të datës 24.02.2023, Autoriteti Kontraktues ka sqaruar, siç vijon:

3.	Kriteri i tenderit nr. 3b, tek Kapaciteti teknik dhe profesional:	<p>3.1. Për kërkesën që Analisti i biznesit (Pika 3.b. e Kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional) të jetë i certifikuar me Professional in Business Analysis deshëm ta dimë se cili është autoriteti lëshues i pranueshëm, respektivisht a pranohet një certifikim i tillë nga autoritetet e fushës së softuerit të akredituar dhe/ se licencuar nga Ministria e Arsimit në Republikën e Kosovës?</p> <p>3.2. A është i pranueshëm që ky person të jetë i diplomuar si</p>	<p>3.1. Kërkesa është për PMI Professional in Business Analysis ose certifikim ekuivalent. Pranohen certifikatat e lëshuara nga institucionet e akredituara/licencuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës</p> <p>3.2 Inxhinierët e elektroteknikës që kanë ndjekur studimet pesëvjeçare</p>
----	---	--	--

		Inxhinier i elektroteknikës, sistem 5 vjeçar?	dhe kandidatët që kanë përfunduar studimet master nuk kanë nevojë të posedojnë këtë certifikatë (e njëjta logjikë vlen për të gjitha pozicionet e tjera).
4.	Kriteri i tenderit nr. 3c, tek Kapaciteti teknik dhe profesional:	4. Për kërkesën që Ekspertet për zhvillimin e aplikacioneve (Pika 3.c. e Kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional) të jenë të certifikuar me .NET teknologji deshëm ta dimë se cili është autoriteti lëshues i pranueshëm respektivisht a pranohet një certifikim i tillë nga autoritetet e fushës së softuerit të akredituar dhe/ose licencuar nga Ministria e Arsimit në Republikën e Kosovës?	4. E njëjta gjë vlen edhe për pikën e mëparshme, njihet lëshimi i certifikatave nga institucionet e akredituara/licencuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës.

Pra, Autoriteti Kontraktues me shkelje flagrante të legjislacionit në fuqi, tërësisht abstrahon kërkesat e Dosjes së Tenderit, Njoftimit për Kontratë siç janë a) që lëshuesi i certifikatave të jetë i Akredituar/licencuar nga Ministria e Arsimit të Republikës së Kosovës dhe b) faktit që PBC Academy si lëshues i certifikatave është i Akredituar/licencuar nga Ministria e Arsimit të Republikës së Kosovës, por [duke ndryshuar, modifikuar ose shtuar kriteret të cilat nuk kanë qenë të përcaktuara] i referohet strukturës së certifikatës, duke u bazuar në një ekspertizë të rrejshme të “ekspertit” të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), z. Kërqeli, të cilin as vetë OSHP nuk e ka marrë në konsideratë. Se z. Kërqeli ka nxjerrë ekspertizë është jashtë kontekstit dhe duke e vënë në lajthitje Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve e dëshmon përgjigja e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve të dhënë ndaj nesh, me datë 25 korrik 2023, si rezultat i verifikimeve tona të manipulimeve të “ekspertit” në fjalë. Një kopje të kësaj përgjigje e gjeni në vazhdim:

From: Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve <info.akk@rks-gov.net>
Sent: Tuesday, July 25, 2023 2:41 PM
To: gasel@pbc.group
Cc: Arber Salihu
Subject: Kerkese per informate

Pershendetje i nderuar,

Urojme qe te jeni mire me shëndet!

Fillimisht ju njoftojme se personeli i AKK eshte pergjegjes per zbatimin e rregullave dhe te procedurave te cilat derivojn nga Ligji per Kualifikimet Kombetare, andaj cdo interpretim apo konstatim i personelit bazen e ka tek ligji perkates.

Andaj bazuar ne kërkesën tuaj per sqarime ashtu sic ju kemi përgjigjur edhe z. Ermet Kerceli, ju njoftojme se PBC Academy eshte institucion i akredituar dhe ka të drejtë të ofrojë trajnime sipas kualifikimit te validuar nga AKK.

PBC Akademy ka akreditim fillestar me kualifikim I cili bazohet ne standarde nderkombetare me titullin "Zhvillues te Softuerit", niveli i V sipas KKK me 120 kredi te AAP. Sipas ketij programi te kualifikimit kete vit ky institucion ka kaluar edhe procesin e ri-akreditimit dhe te ri-validimit.

Sa i perket permbajtjes se programit te PBC Akademy, ne ju njoftojme se kualifikimi i lartcekur eshte valid dhe pjese e Kornizes Kombetare te Kualifikimeve.

Megjithate nese ju nevojiten informata shtese rreth permbajtjes dhe formatit te ketyre kualifikimeve dhe se ato certifikime a kane ndodhur ne kuader te programit te validuar, per kete ju duhet te kerkoni informata nga institucioni PBC Akademy.

Poashtu edhe per qeshtjen lidhur me menyren e ofrimit te trajnimit dhe certifikimit ju lutem te I drejtoheni institucionit ofrues sepse eshte ne te drejten e tyre per dhenien e informatave te tilla.

Me respekt!

Figura 2. Përgjigja e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve

Andaj, bazuar në gjendjen faktike të mësipërme, kërkojmë që ju si Autoritet Kontraktues lëndën ta ktheni në RIVLERËSIM dhe t'i përmbaheni detyrimeve ligjore në fuqi, si dhe të mos devijoni kërkesat e Dosjes së Tenderit, Njoftimit për Kontratë, sqarimeve shtesë të datës 16.02.2023 dhe Formularit B54 të datës 24.02.2023, nga "certifikatat e lëshuara nga institucionet e akredituara/licencuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës" në Certifikata të verifikuara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve. Sepse, **këto gjëra janë tërësisht të ndryshme**. Në të kundërtën, përveç shkeljeve të mësipërme, ju bini në desh edhe me paragrafin 2 të nenit 8, nenin 21, nenin 22, nenin 24, nenin 31 dhe nenin 278 të Kodit Penal të Kosovës, me numër 06/L-074. Për çka, të detyruar nga paragrafi 1.7 i nenit 378 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, jemi të detyruar që konform paragrafit 1 të nenit 59 të LPP, që së paku për anëtarët e komisionit vlerësues të paraqesim Kallëzim Penal pran Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Dëmet materiale

Dëmet materiale janë të dyanshme. Për ne, fitimi i humbur që do pasqyrohej pas një analize gjyqësore financiare dhe dëmtimi i interesit të publikut, qoftë nga mungesa/vonesa e implementimit të Sistemit Informativ Shëndetësor, qoftë nga kompensimi i fitimit të humbur.

Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

AK-MSh qëndron prapa Njoftimit mbi Vendimin e AK te datës 25.10.2023, ku oferta juaj është trajtuar si e papërgjegjshme për arsyet e cekura ne B42 Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar dhe qe ky aktivitet te anulohet për mungese te ofertave te përgjegjshme.

Tregues shtesë për nevojën e anulimit te AP është edhe aspekti financiar, bazuar ne paragrafin 1 i nenit 1 te LPP-se, ne lidhje me dallimin e madh ne çmim prej **531,251.69 euro**, ne mes ofertës tuaj 1,064,375.69 euro dhe ofertës tjetër pretenduese 533,124.00 euro.

Sa i përket pajtueshmërisë tuaj me konstatimin e ekspertit të huaj që HIFIS dhe HIS janë dy sisteme të ndryshme, nuk kemi çfarë te shtojmë ne këtë çështje, pasi qe për këtë çështje gjate rivlerësimit kemi kërkuar opinion ligjor te Departamenti Ligjor i MSh-se dhe prej tyre kemi pranuar përgjigjen me shkrim me nr. protokollit 05-6593/2 te datës 24.10.2023, ku është sqaruar se Fondi i Sigurimeve Shëndetësore nuk i takon ndonjërit nga nivelet e shëndetësisë, siç është kërkuar ne kriterin e NJK dhe DT.

Sa i përket pretendimit nr. 2, ne lidhje me diskualifikimin e ofertës tuaj si dhe pretendimit për shkelje te paragrafit 1 të nenit 7 te LPP-se, ne nuk pajtohemi me këtë pretendim dhe konsiderojmë se i kemi trajtuar operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese, si dhe kemi vepruar në mënyrë transparente.

Baze për Ri-vlerësimin e aktivitetit ka qene Vendimi i OSHP-se nr. 282/23 i datës 13.09.2023, i cili ka qene mjaft i qarte dhe nder te tjera PSH ka kërkuar qe: ***mbetet në përgjegjësi të plotë të AK-së që të vlerësojë dhe ekzaminojë ofertat konform dispozitave të LPP-së në relacion me pretendimet ankimore të OE ankues.***

Sa i përket pretendimit rreth certifikatave te lëshuara nga PBC Academy, konsiderojmë se sqarimi i dhënë me shkrim nga Autoriteti Kombëtar te Kualifikimeve, me emailin e me poshtëm për ekspertin shqyrtues, është mjaft i qarte se Kandidatet e certifikuar qe i keni bashkangjitur nuk i kane certifikatat e verifikuara nga AKK duhet ta keni parasysh qe çdo kandidat i certifikuar duhet ta ketë certifikatën e verifikuar nga AKK.

A

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve <info.akk@rks-gov.net>

To: ernest kerqeli

Cc: You

Pershendetje i nderuar,

PBC Akademi mund te leshoj certifikata vetem per kualifikime te validuara sipas vendimit te K

Kandidatet e certifikuar qe i keni bashkangjitur nuk i kane certifikatat e verifikuara nga AKK, du certifikuar duhet ta kete certifikaten e verifikuar nga AKK.

Se ato certifikime a kan ndodhur ne kuader te programit te validuar duhet te kerkoni informat

Gjithe te mirat!



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Rr./Str. Agim Ramadani, 26, Prishtinë

www.akkks.rks-gov.net

Ekspertet shqyrtues kane verifikuar validitetin e certifikatave te ofertës tuaj, ku janë sqaruar edhe me Autoritetin Kombëtar te Kualifikimeve (AKK), përshkrimi si ne vijim:

Megjithatë, ka dyshime lidhur me validitetin e certifikatave nga OE ankues, duke pretenduar se certifikatat e ofruara nga OE e rekomanduar per kontrate nuk përmbushin këtë kusht, pasi nuk kanë kredibilitet për shkak të mungesës së datës së lëshimit dhe të dhënave që duhet të posedojë një certifikatë e tillë e lëshuar nga institucionet vendore konform ligjit në fuqi, institucioni që lëshon çfarëdo lloje certifikate do te duhej te jete i akredituar për atë program. Për të sqaruar këtë çështje, kam kontakte zyrtarisht me Autoritetin Kombëtar të Akreditimit, duke iu drejtuar atyre me anë të emailit, pyetjeve si në vijim:

Siç mund te shihet, nga komentet e dhëna nga AKK, lidhur me certifikatat te cilat ju i keni prezentuar ne DT, pasi ato nuk kanë vullën e AKK, bazuar ne përgjigjen zyrtare te pranuar nga AKK-ja, ato nuk janë valide dhe si te tilla nuk e plotëson kriterin sipas DT.

Ne baze te sqarimeve te dhëna nga AKK, shihet se certifikatat e ofruara nga ana juaj, nuk janë te verifikuara nga AKK, bazuar ne veb faqen e AKK, ne linkun: <https://akkks.rks-gov.net/Documents?idType=1024>, te Lista e Institucioneve te akredituara, dëshmohet se PBC Academy është e akredituar për lëshimin e certifikatave vetëm si Zhvillues i softwerit

28	PBC Academy	Prishtinë	Zhvillues i softwerit	V	124	10/1/2022	9/30/2025
----	-------------	-----------	-----------------------	---	-----	-----------	-----------

Sa i përket pretendimit rreth sqarimeve ne fazën e tenderimit se: "Pranohen certifikatat e lëshuara nga institucionet e akredituara/licencuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës" – kjo nuk e arsyeton pretendimin tuaj, meqenese kjo nuk nenkupton se lejohen certifikatat per lami jashta fushes se akreditimit dhe as certifikata te pa akredituara.

Certifikatat e ofruara nga ana juaj nuk kane date te lëshimit e as validitet, si shembull e bashkangjesim nje te tille ne vijim, ku përveç vullës se noterisë, mungon data e lëshimit, validiteti, dhe verifikimi nga AKK:



CERTIFICATE


THIS IS TO CERTIFY THAT

Elirida Rrmoku



has successfully completed the training:

On-site Support for Software use



Begunbler

PBCA, CEO

Si përfundim, ne si AK qëndrojmë prapa Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 25.10.2023, që ky aktivitet të anulohet për mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit